



01Nr. 112102-16695
Datë: 23.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, si dhe nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me raportin e Komisionit të Vlerësimit të Granteve të vitit 2023, me datë 23.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mjeteve buxhetore sipas raportit të prezantuar nga Komisioni i Vlerësimit të Granteve komunale për vitin 2023, për mbështetje financiare të bizneseve për programin “Fondi Zhvillimor për Ndërmarrje Mikro dhe të Vogla” për bizneset ekzistuese dhe Start-up, Loti I dhe Lot II, duke i mbështetur me mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 109,032.72€ nga linja e subvencioneve për ndarjen e granteve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizojë procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 109,032.72€ nga mjetet e fondit të Subvencioneve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, në bazë të të dhënave të listës së bizneseve përfituese të granteve komunale për vitin 2023 si dhe kontratave të lidhura me përfituesit.
3. Mjetet financiare në vlerë prej 109,032.72€ do të barten në xhirollogaritë e bizneseve si përfitues të granteve komunale për vitin 2023, sipas vlerave të përshkruara nga raporti i Komisionit të Vlerësimit dhe të Kontratave, që janë pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit të Komunës;
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës së Gjakovës


Ardian Gjini
